

Kronikë

Arrestohet 49-vjeçari në Pogradec, ishte i armatosur! I dënuar edhe më parë për armëmbajtje pa leje

Një atentat i mundshëm mund të jetë shmangur me arrestimin e 49-vjeçarit, Artur Musollari në Pogradec. Gjatë kontrollit u gjet armë zjarri, fishek, një shkop bejsbolli, sasi parash, një palë dylbi dhe një aparat celular.

[Sh] Redaksia
10 Korrik, 15:12 | Përditësimi: 10 Korrik, 15:18

Share



A A

POGRADEC- Një atentat i mundshëm mund të jetë shmangur me arrestimin e 49-vjeçarit, Artur Musollari në Pogradec. Gjatë kontrollit u gjet armë zjarri, fishek, një shkop bejsbolli, sasi parash, një palë dylbi dhe një aparat celular. Të gjitha sendet që posedonte me vetme, evidenton se është shmangur një ngjarje e mundshme kriminale. Megjithatë, policia nuk ka një informacion konkret lidhur me motivin që mund të kishte Artur Musollari.

Si rrjedhojë e ndërhyrjes së policisë, janë sekuestruar arma e zjarrit, municion luftarak, një shkop bejsbolli, sasi parash në valuta të ndryshme, një automjet, një palë dylbi dhe një aparat celular.



LEXO EDHE:
Fermerët në Maliq djegin barin për të pastruar tokën, flakët rrezikojnë sipërfaqet me grurë

Musollari u kap në lagjen nr. 1, Pogradec, shërbimet e Policisë kanë lokalizuar 49-vjeçarin dhe gjatë kontrollit të ushtruar në çantën e tij, kanë gjetur një armë zjarri tip pistoletë me fishek në fole, gati për qitje, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale. Në vijim të veprimeve procedurale, gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin dhe në banesën e këtij shtetasi, u gjetën sasi parash në valuta të ndryshme, një shkop bejsbolli, një palë dylbi dhe një aparat celular.

Për shkak të sekretit hetimor, duke qenë se ngjarja është në hetim, nuk jepen detaje të tjera në lidhje me motivet dhe objektivin e synuar nga i arrestuari.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për veprime të mëtejshme.

G.MO/r.k./Shqiptarja.com

TAG: [artur musollari](#) [armëmbajtje pa leje](#) [Korce](#)

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

Sondazhi i ditës:

Akuzat për korrupsion, a duhet të hapet rruga për arrestimin e Ahmetajt?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera



Tomas Delpier i apasionuar pas gjuhëve të huaja! Psikologu belg njej 16 gjuhë: Shqipen e mësova nga librat



Armand Braho

9 Korrik, 16:21



Vendosën muzikë të lartë në lokal mbi orarin e lejuar, nën hetim pronari i lokalit dhe tre muzikantë në Korçë

9 Korrik, 10:08



S'ka bashkim me Tiranën, Kushi: Universiteti i Korçës i ka të gjitha kapacitetet! Do rritet përmes ndërkombëtarizmit dhe profilizimit

8 Korrik, 14:03



Procesi i Berlinit, ambasadori gjerman: Qeveria shqiptare po merr seriozisht organizimin e samitit ne Tiranë! Tregon rëndësinë që ka rajoni

6 Korrik, 12:32



Sekuestrohet varka e peshkimit në liqenin e Ohrit, kryente gjueti të paligjshme

5 Korrik, 18:48



'5 ditët e UNESCO-s', aktivitete promovuese në Pogradec! Drejtoresha e muzeut: Do promovohen pikat historike dhe natyrore



Armand Braho

5 Korrik, 17:14



Akuzohej për abuzim me tenderin e druve, GJKKO shpall të pafajshëm ish-kryebashkiakun e Pogradecit, Eduart Kapri

4 Korrik, 16:47



Pogradec/ Fluks në pediatri, 60 fëmijë në ditë për vizita! Mjeku: Shkak virozat e stinës

4 Korrik, 16:38



'Në kuadër të dashurisë', Luiz Ejlli performon live në sheshxhirimin e filmit

4 Korrik, 14:00



Ministria e Bujqësisë vizitë në Itali, Krifca: Së shpejti inkubatorë për përpunimin e peshkut dhe frutave në Vlorë dhe Korçë

4 Korrik, 12:50



Aksident në Korçë! Humbi kontrollin e mjetit dhe doli nga rruga, plagoset e moshura, nipi dhe mbesa e saj

3 Korrik, 19:30



Korçë/ Mbahet festivali i muzikës baroke 'Vox Baroque', drejtuesi: Ky qytet e 'dashuron' muzikën

2 Korrik, 21:20



RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton